 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-734/018	Data: Datum: 30.10.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), me kërkesë të Udhëheqëses Sektorit të Prokurimit për formim të komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: “Ndërtimi i kanalizimit në Lubozhdë-Laxha Januzaj” me numër të brendshëm të prokurimi 633/018/075/521, dhe nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për Vlerësimin e ofertave për projektin: “Ndërtimi i kanalizimit në Lubozhdë-Laxha Januzaj” me numër të brendshëm të prokurimi 633/018/075/521 dhe në Komision caktohen:

1. Naser Gjocaj, Udhëheqës i Sektorit për Mjedisë dhe Eficiencë, Kryetar komisioni;
2. Naser Nimanaj, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, anëtar; dhe
3. Elfete Blakaj, Udhëheqëse e Sektorit Mbrojtje të Mjedisit, anëtare;

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterit të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: “Ndërtimi i kanalizimit në Lubozhdë-Laxha Januzaj”, si dhe do t’i kryejë punët dhe përgjegjësit të tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Anëtarët e komisionit dhe Sektori i Prokurimit.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Anëtarët e Komisionit, Sektori i Prokurimit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-737/018	Data: Datum: 31.10.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), me kërkesë të Udhëheqëses Sektorit të Prokurimit për verifikimin e punimeve për punë shtesë të projektit: "Mirëmbajtja e adresave", me numër të prokurimi 633-017-012-221 të realizuar nga operatori "Lindimarkings" N.T nga fsh.Vitomericë, nxjerr:

V E N D I M

Formohet Komisioni për verifikimin e punimeve për projektin: "Mirëmbajtja e adresave", me numër të prokurimi 633-017-012-221 të realizuar nga operatori "Lindimarkings" N.T, dhe në komision caktohen:

- 1). Rexhep Blakaj, Udhëheqës i Sektorit për Urbanizem, Kryetar Komisioni;
 - 2). Sami Podrimaj, Zyrtar për Kadaster dhe Gjeodozi, dhe
 - 3). Bushat Gashi, Zyrtar për Kadaster, anëtar.
2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin e projektit të cekur në pikën II. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj mbikëqyrësin e punimeve, do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve në projektin e cekur; do të hartojë procesverbalin mbi pranimin teknik të projektit si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat të tjera që kanë të bëjnë me natyrën e komisionit të tillë.
3. Komisioni do të filloj ti kryej punët menjëherë, si dhe të gjitha punët administrativo-juridike për nevoja të komisionit do t'i kryejë: Zyra e Prokurimit.
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: anëtarët e komisionit dhe Zyra e prokurimit.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: anëtarët e komisionit, operatori "Lindimarkings" N.T, Zyra e Prokurimit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-738/018	Data: Datum: 31.10.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), me kërkesë të Udhëheqëses Sektorit të Prokurimit për verifikimin e punimeve për punë shtesë të projektit: "Mirëmbajtja e infrastrukturës shkollore Loto 1 dhe shënjëzimi i vijave në fushat sportive Loto 2", me numër të prokurimi 633-017-052-521 të realizuar nga operatori "NATONI" SH.P.K nga fsh. Tomoc, nxjerr:

V E N D I M

- Formohet Komisioni për verifikimin e punimeve për projektin: "Mirëmbajtja e infrastrukturës shkollore Loto 1 dhe shënjëzimi i vijave në fushat sportive Loto 2", me numër të prokurimi 633-017-052-521 të realizuar nga operatori "NATONI" SH.P.K, dhe në komision caktohen:
 - 1). Sami Ferati, Udhëheqës i Sektorit për Arsim, Kryetar Komisioni;
 - 2). Naim Sadrijaj, Drejtor i SFMU "Ndre Mjeda" në Rakosh, dhe
 - 3). Sadik Bicaj, Drejtor i SFMU "Hysni Zajmi" në Vrella, anëtar.
- Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin e projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj mbikëqyrësin e punimeve, do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve në projektin e cekur; do të hartojë procesverbalin mbi pranimin teknik të projektit si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat të tjera që kanë të bëjnë me natyrën e komisionit të tillë.
- Komisioni do të filloj ti kryej punët menjëherë, si dhe të gjitha punët administrativo-juridike për nevoja të komisionit do t'i kryejë: Zyra e Prokurimit.
- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: anëtarët e komisionit dhe Zyra e prokurimit.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: anëtarët e komisionit, operatori "NATONI" SH.P.K, Zyra e Prokurimit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE		 Komuna e Istogut Opština Istok
	01 Nr.744 /18	Data: 31.10.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13., nenin 58. Pika f dhe nenit 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Qeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 74. Paragrafi 2. të Statutit të Komunës 01nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. z.Besart Dreshaj, Ekonomist i diplomuar, me vendbanim në Vrellë, Komuna e Istogut, deri tani Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim i pushon mandati i Drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, për shkak të kalimit në detyrë të re.
2. Obligohet Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime të bëjë kërkesën, në Departamentin e Shërbimit Civil – Divizioni për Paga dhe Mëditje, në Ministrin e Administratës Publike, për largimin e të përmendurit nga lista e pagave prej datës 31.10.2018.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe hynë në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: z. Besart Dreshaj, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki Rugova

 Republika e Kosovës Republika Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE		 Komuna e Istogut Opština Istok
	01 Nr.748/018	Data: 01.11.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, nenin 58 pika f dhe neni 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 74. Paragrafi 2. të Statutit të Komunës 01Nr.62/010 të datës 30.11.2010, për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis, nxjerr:

V E N D I M

1. z.Besart Dreshaj, Ekonomist i diplomuar, me vendbanim në Vrellë, Komuna e Istogut, emërohet Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis.
2. Me ushtrimin e funksionit të Drejtorit të Drejtorisë të cekur i përmenduri do t'ia fillojë nga: 01.11.2018.
3. Mandati i të emëruarit është i njëjtë me mandatin e Kryetarit të Komunës, me mundësi ndërprerje para skadimit në rast shkarkimi apo dorëheqje.
4. I përmenduri do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë Nr.16/2008.
5. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.
6. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: z. Besart Dreshaj, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki Rugova

 Republika e Kosovës Republika Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE		 Komuna e Istogut Opština Istok
	01 Nr.743 /18	Data: 31.10.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13., nenin 58. Pika f dhe nenit 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Qeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 74. Paragrafi 2. të Statutit të Komunës 01nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. z.Lulzim Blakaj, Jurist i diplomuar, me vendbanim në Istog, Komuna e Istogut, deri tani Nënkyetar i Komunës i pushon mandati i Nënkyetarit të Komunës, për shkak të kalimit në detyrë të re.
2. Obligohet Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime të bëjë kërkesën, në Departamentin e Shërbimit Civil – Divizioni për Paga dhe Mëditje, në Ministrin e Administratës Publike, për largimin e të përmendurit nga lista e pagave prej datës 31.10.2018.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe hynë në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: z. Lulzim Blakaj, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki Rugova



 Republika e Kosovës Republika Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE		 Komuna e Istogut Opština Istok
	01 Nr.747/018	Data: 01.11.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, nenin 58 pika f dhe neni 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 74. Paragrafi 2. të Statutit të Komunës 01Nr.62/010 të datës 30.11.2010, për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, nxjerr:

V E N D I M

1. z.Lulzim Blakaj, Jurist i diplomuar, me vendbanim në Istog, Komuna e Istogut, emërohet Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim.
2. Me ushtrimin e funksionit të Drejtorit të Drejtorisë të cekur i përmenduri do t'ia fillojë nga: 01.11.2018.
3. Mandati i të emëruarit është i njëjtë me mandatin e Kryetarit të Komunës, me mundësi ndërprerje para skadimit në rast shkarkimi apo dorëheqje.
4. I përmenduri do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë Nr.16/2008.
5. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.
6. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: z. Lulzim Blakaj, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki Rugova



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-739/018	Data: Datum: 31.10.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën Nr.10-400-52053 të datës 25.10.2018 e parashtruar nga Shoqata "ĐERDAN" nga Vitomirica të cilën e përfaqëson Izet Kojić, për realizimin e projektit "Festivali i Boshnjakve" për diasporën, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.10-400-52053 të datës 25.10.2018 e parashtruar nga Shoqata "ĐERDAN" nga Vitomirica të cilën e përfaqëson Izet Kojić, për realizimin e projektit "Festivali i Boshnjakve" dhe i ndahen 500.00 euro (pesëqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Ktim për realizimin e projektit Festivali i Boshnjakve" për diasporën.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Shoqatës "ĐERDAN" në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyra Komunale për Komunitete dhe Ktim.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Shoqata "ĐERDAN", ka parashtruar kërkesën Nr.10-400-52053 të datës 25.10.2018, me të cilën ka kërkuar që të përkrahet me mjete financiare për realizimin e projektit "Festivali i Boshnjakve" për diasporën.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar shihet se është e një rëndësie të veçante organizimi dhe mbajta e projektit "Festivalit të Boshnjakve" dhe përkrahet financiarisht me 500.00€.

Në plan programin buxhetor të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Ktim, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje individuale dhe të projekteve.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Shoqatës "ĐERDAN", në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit njoftohen: Izet Kojić- Shoqata "ĐERDAN", Zyra Komunale për Komunitete dhe Ktim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-740/018	Data: Datum: 31.10.2018	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), nenin 12 par 12.3 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.04/L-081, nenit 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2011 për punët dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpitë me bazë në komunitet, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe pranimin e rezidentëve në Shtëpinë e Komunitetit në Gurakoc, shqyrtoj kërkesën Nr.06-016-53027 të datës 01.11.2018, të parashtruar nga Qendra për Punë Sociale në Istog, për lejin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për Dyka (Januz)Halilaj nga Cerrca Komuna Istog, dhe i propozon Kryetarit të Komunës të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa Nr.06-016-53027 të datës 01.11.2018, të parashtruar nga Qendra për Punë Sociale në Istog, për lejin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për Dyka (Januz) Halilaj, me nacionalitet shqiptar, me shtetësi Kosovare e lindur më 08.04.1936 në fshatin Zhakovë, e me vendbanim në fsh.Cerrcë, Komuna Istog.
2. Shtëpia e Komunitetit në Gurakoc është përgjegjëse për përkujdesjen ndajë Dyka (Januz)Halilaj, gjatë qëndrimit në institucion.
3. Obligohet Organi i Kujdestarisë pranë QPS-së në Istog, të përgatis rastin për vendosje, të bartë dosjen e klientit në shtëpinë e komunitetit në Gurakoc dhe të mbikëqyr gjendjen e klientës.
4. Vendimi është përfundimtar.

Arsyetim

Komisioni i Komunës për shqyrtimin e kërkesave për strehimin e të moshuarve, shqyrtoj dhe miratoj kërkesën Nr.06-016-53027 të datës 01.11.2018, me të dhënat e paraqitura nga QPS-ja në Istog dhe pas shikimit të Anamnezës sociale konstatoj se Dyka Halilaj, ka nevojë të vendoset në shtëpinë e komunitetit në Gurakoc.

Qendra për Punë Sociale në Istog, e ka vizituar në teren Dyken, e cila ka qenë e martuar në fsh.Veriq dhe në ate martes nuk kanë pasur pasardhes, Dyka jeton me motrën Hyke Rexhaj e cila është po ashtu e moshuar pa pasardhes dhe e vetme e cila deri me tani është kujdesur për të, por tani edhe ajo është në moshë të shtyer dhe nuk mund të kujdeset për veten e saj dhe as për të. Dyka deri me tani ka jetuar në një shtëpi të vogël të ndertuar në mënyrë humane nga humanitarët e rrethit të gjerë familjar, nga patundshmeria sipas evidencës katastrale të Komunës së Istogut Nr.1883, nuk posedon tokë si dhe nga lujëshmëria-patundshmeria nuk posedon asgjë. Duke e parë gjendjen shëndetësore Dyka është person e molisur nga pleqëria ka vështirësi në ecje, nga mosha e shtyerë ka nevojë për përkujdesje institucionale, andaj është e domosdoshme vendosja dhe përkujdesja institucionale në Shtëpinë e Komunitetit pa përkujdesje familjare në Gurakoc.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen:Dyka Halilaj, Haki Ibrahimaj, drejtor i QPS-së Istog, Përgjegjësi i shtëpisë së komunitetit në Gurakoc, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-741/018	Data: Datum: 31.10.2018	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), nenin 12 par 12.3 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.04/L-081, nenit 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2011 për punët dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpitë me bazë në komunitet, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe pranimin e rezidentëve në Shtëpinë e Komunitetit në Gurakoc, shqyrtoj kërkesën Nr.06-016-53028 të datës 01.11.2018, të parashtruar nga Qendra për punë Sociale në Istog, për lejin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për lejin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për Hyka (Januz)Rexhaj nga Cerrca Komuna Istog, dhe i propozon Kryetarit të Komunës të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa Nr.06-016-53028 të datës 01.11.2018, të parashtruar nga Qendra për punë Sociale në Istog, për lejin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për Hyka (Januz)Rexhaj, me nacionalitet shqiptar, me shtetësi Kosovare e lindur më 01.03.1930 në fshatin Zhakovë, e me vendbanim në fsh.Cerrcë, Komuna Istog.
2. Shtëpia e Komunitetit në Gurakoc është përgjegjëse për përkujdesjen ndaj Hyka (Januz)Rexhaj, gjatë qëndrimit në institucion.
3. Obligohet Organi i Kujdestarisë pranë QPS-së në Istog, të përgatis rastin për vendosje, të bartë dosjen e klientit në shtëpinë e komunitetit në Gurakoc dhe të mbikëqyr gjendjen e klientës.
4. Vendimi është përfundimtar.

Arsyetim

Komisioni i Komunës për shqyrtimin e kërkesave për strehimin e të moshuarve, shqyrtoj dhe miratoj kërkesën Nr.06-016-53028 të datës 01.11.2018, me të dhënat e paraqitura nga QPS-ja në Istog dhe pas shikimit të Anamnezës sociale konstatoj se Hyka Rexhaj, ka nevojë të vendoset në shtëpinë e komunitetit në Gurakoc.

Qendra për Punë Sociale në Istog, e ka vizituar në teren Hyken, e cila ka qenë e martuar në fsh.Veriq të Istogut, dhe në atë martes nuk kanë pasur pasardhës pas vdekjes së bashkëshortit Hyka ka mbetur e vetme pa përkujdesje dhe është vendosur në fsh. Cerrcë bashkë me motrën e saj Dyka(Januz)Halilaj e cila është po ashtu e moshuar dhe pa pasardhës, para 2 viteve gjendja e tyre ka qenë më e mirë dhe kanë qenë të afta të kujdesen për njëra-tjetren por momentalisht janë në gjendje të rëndë shëndetësore pothuajse të palëvizshme as për nevojat e tyre personale.Hyka deri me tani ka jetuar në një shtëpi të vogël të ndërtuar në mënyrë humane nga humanitaret e rrethit familjarë, nga patundshmëria sipas evidencës katastrale të komunës së Istogut.Nr.1884, nuk posedon tokë si dhe nga lujshmëria-patundshmëria nuk posedon asgjë. Duke e parë gjendjen shëndetësore Hyka është person e molisur nga plëqeria ka vështirësi në ecje, nga mosha e shtyerë ka nevojë për përkujdesje institucionale, andaj është e domosdoshme vendosja dhe përkujdesja institucionale në Shtëpinë e Komuniteteve pa përkujdesje familjare në Gurakoc.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen:Hyka Rexhaj, Haki Ibrahimaj, drejtor i QPS-së Istog, Përgjegjësi i shtëpisë së komunitetit në Gurakoc, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komunë e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-742/018	Data: Datum: 31.10.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), dhe në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punë në sektorin publik, me qellim të intervistimit të kandidatëve që kanë konkurruar sipas konkursit Nr.206 të datës 11.10.2018 nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin Nr.206 të datës 11.10.2018, për vendin e punës: Ndhmëse Mjeksores në Shtëpinë e komunitetit për persona të moshuar në fsh. Gjirakoc dhe në Komision caktohen:
 - 1). Brahim Hetemaj, Udhëheqës i Sektorit për Shëndetësi, Kryesues i Komisionit;
 - 2). Naim Sylaj, Zyrtar për Shërbime Sociale 2, anëtar;
 - 3). Shyhrete Hakaj, Teknike Medicinale, anëtare;
 - 4). Verditë Bajraktaraj, Teknike Medicinale, anëtare;
 - 5). Muhamet Maleshaj, Zyrtar për kordinimin e të Drejtave dhe Integrimin e Komuniteteve, anëtar.
2. Komisioni i cekur do të mbajë intervistimin me kandidatët të cilët kanë konkurruar për vendin e punës: Ndhmëse Mjeksores në Shtëpinë e komunitetit për persona të moshuar në fsh. Gjirakoc, në pajtim me procedurat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011, për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punë në sektorin publik, me listën e kandidatëve të radhitur sipas pikëve të fituara të njoftojë Menaxherin e Personelit për procedim të mëtejshëm.
3. Të gjitha punët tekniko administrative për nevojat e komisionit do të kryejë: Zyra e Personelit.
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: anëtarët e komisionit.

Me kopje të këtij Vendim do të njoftohen: anëtarët e komisionit, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE		 Komuna e Istogut Opština Istok
	01 Nr.745 /18	Data: 31.10.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13., nenin 58. Pika f dhe nenit 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Qeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 74. Paragrafi 2. të Statutit të Komunës 01nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. z.Isa Hoxhaj, Inxhinier i Diplomuar i Maqinerisë, me vendbanim në Istog, Komuna e Istogut, deri tani Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis i pushon mandati i Drejtor të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis, për shkak të kalimit në detyrë të re.
2. Obligohet Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime të bëjë kërkesën, në Departamentin e Shërbimit Civil – Divizioni për Paga dhe Mëditje, në Ministrin e Administratës Publike, për largimin e të përmendurit nga lista e pagave prej datës 31.10.2018.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe hynë në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: z. Isa Hoxhaj, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki Rugova

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-696/017	Data: Datum: 19.10.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 77, 84 dhe 87 të Ligjit për Procedurën Administrative Nr.02/L-28 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.08/2007), nenin 68.1 pika 2 e Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, nenit 8, paragrafi 8.2 të Ligjit Nr.02/L-53 për Gjuetinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.08. dt. 01.01.2007), nenet 2,3,4,5,6,7 dhe 11 të Udhëzimit Administrativ MA-Nr.11/2007 për Sezonin e Gjuetisë të datës 14.09.2007, shqyrtoi kërkesën Nr. 09-320-18547 të datës 16.04.2018 e parashtruar nga Shoqata e Gjahtarëve "Gurrat e Bardha", Komuna e Istogut, për hapjen e sezonit të gjuetisë dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr. 09-320-18547 të datës 16.04.2018 e parashtruar nga Shoqata e Gjahtarëve "Gurrat e Bardha", Komuna e Istogut, për hapjen e sezonit të gjuetisë.
2. **Sezoni i gjuetisë është i hapur nga data 21.10.2018 për vitin 2018-2019 dhe vazhdon deri sa Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të njofton Komunën, Policinë dhe Shoqatën për ndërprerjen e sezonin e gjuetisë.**
3. **Obligohet Shoqata e Gjahtarëve "Gurrat e Bardha" të zbatojë në përpikëri, Ligjin për Gjuetinë Nr.02/L-53 dhe Udhëzimi Administrativ për Sezonin e Gjuetisë MA-Nr.11/2007.**
4. **Sezoni i gjuetisë mund të organizohet vetëm gjatë ditëve të diela.**
5. **Për zbatimin e këtij Vendimi të kujdeset: Shoqata e Gjahtarëve "Gurrat e Bardha", Policia e Kosovës, njësia në Istog dhe Pylltaria.**
6. **Vendimi është përfundimtar.**

Me nga një kopje të Vendimit njoftohen: Shoqata e Gjahtarëve "Gurrat e Bardha", Policia e Kosovës njësia në Istog, Pylltaria dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës,
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-697/018	Data: Datum: 19.10.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr. 28/2008), me kërkesë të Udhëheqëses së Sektorit të Prokurimit për formim të komisionit për vlerësimin e ofertave në projektin “ Mirëmbajtja e objektit të komunës ” me numër të brendshëm 633/18/068/521 nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për Vlerësimin e ofertave në projektin “ Mirëmbajtja e objektit të komunës ” me numër të brendshëm 633/18/068/521 dhe në të caktohen:
 - 1) **Rrustem Gashi**, Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim, kryesues;
 - 2) **Faton Bytyçi**, Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative, anëtar;
 - 3) **Fazli Stollaj**, Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative, anëtar.
2. Komisioni i cekur me lartë ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitura në dosjen e tenderit në projektin “Mirëmbajtja e objektit të komunës ” si dhe do t’i kryejë punët dhe përgjegjësitë tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Anëtarët e Komisionit dhe Sektori i Prokurimit.

Me nga një kopje të këtij Vendimi njoftohen: Anëtarët e Komisionit, Sektori i Prokurimit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-699/018	Data: Datum: 19.10.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 5, pika d të Ligjit për Arsim në Komuna e Republikës së Kosovës 03/L-068, neni 8, paragrafi 3, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.08/2014 për Procedura dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues si dhe në bazë të Rekomandimit të Drejtorisë për Arsim 05 Nr. 652/18, të datës 18.10.2018, mori këtë:

V E N D I M

I vazhdohet kontrata e punës drejtorit të institucionit arsimor si në vijim:

1. **Z. Sadik Bicaj**, Drejtor i SHFMU-së “ Hysni Zajmi ” në Vrellë, prej 01.11.2018 i vazhdohet kontrata e punës edhe për 4 vite.
2. Obligohet Drejtoria për Arsim që drejtorit të lartcekur në pikën 1 t'i vazhdohet kontrata e punës në pajtim me procedurat e përcaktuara në udhëzimet administrative.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset, Drejtoria për Arsim.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: drejtori i lartcekur, drejtoria për arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-700/018	Data: Datum: 19.10.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 5, pika d të Ligjit për Arsim në Komuna e Republikës së Kosovës 03/L-068, neni 8, paragrafi 3, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.08/2014 për Procedura dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues si dhe në bazë të Rekomandimit të Drejtorisë për Arsim 05 Nr. 652/18, të datës 18.10.2018, mori këtë:

V E N D I M

I vazhdohet kontrata e punës drejtorit të institucionit arsimor si në vijim:

1. **Z. Beqir Ibrahimaj**, Drejtor i SHFMU-së “Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe ” në Uçë, prej 01.11.2018 i vazhdohet kontrata e punës edhe për 4 vite.
2. Obligohet Drejtoria për Arsim që drejtorit të lartcekur në pikën 1 t'i vazhdohet kontrata e punës në pajtim me procedurat e përcaktuara në udhëzimet administrative.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset, Drejtoria për Arsim.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: drejtori i lartcekur, drejtoria për arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-701/018	Data: Datum: 19.10.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 5, pika d të Ligjit për Arsim në Komuna e Republikës së Kosovës 03/L-068, neni 8, paragrafi 3, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.08/2014 për Procedura dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues si dhe në bazë të Rekomandimit të Drejtorisë për Arsim 05 Nr. 652/18, të datës 18.10.2018, mori këtë:

V E N D I M

I vazhdohet kontrata e punës drejtorit të institucionit arsimor si në vijim:

1. **Z. Bajram Metaj**, Drejtor i SHFMU-së "Zymer Zeka " në Kaliqan, prej 01.11.2018 i vazhdohet kontrata e punës deri më 07.06.2019 kur edhe pensionohet.
2. Obligohet Drejtoria për Arsim që drejtorit të lartcekur në pikën 1 t'i vazhdohet kontrata e punës në pajtim me procedurat e përcaktuara në udhëzimet administrative.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset, Drejtoria për Arsim.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: drejtori i lartcekur, drejtoria për arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-702/018	Data: Datum: 19.10.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 5, pika d të Ligjit për Arsim në Komuna e Republikës së Kosovës 03/L-068, neni 8, paragrafi 3, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.08/2014 për Procedura dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues si dhe në bazë të Rekomandimit të Drejtorisë për Arsim 05 Nr. 652/18, të datës 18.10.2018, mori këtë:

V E N D I M

I vazhdohet kontrata e punës drejtorit të institucionit arsimor si në vijim:

1. Znj. **Fatmire Rugova**, Drejtoreshë e çerdhes “Gëzimi Ynë “ në Istog, prej 01.11.2018 i vazhdohet kontrata e punës edhe për 4 vite.
2. Obligohet Drejtoria për Arsim që drejtoreshës së lartcekur në pikën 1 t'i vazhdohet kontrata e punës në pajtim me procedurat e përcaktuara në udhëzimet administrative.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset, Drejtoria për Arsim.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: drejtoresha e lartcekur, drejtoria për arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-703/018	Data: Datum: 19.10.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 5, pika d të Ligjit për Arsim në Komuna e Republikës së Kosovës 03/L-068, neni 8, paragrafi 3, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.08/2014 për Procedura dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues si dhe në bazë të Rekomandimit të Drejtorisë për Arsim 05 Nr. 652/18, të datës 18.10.2018, mori këtë:

V E N D I M

I vazhdohet kontrata e punës drejtorit të institucionit arsimor si në vijim:

1. Znj. **Mirjeta Beqiraj**, Drejtoreshë e çerdhes "Lulet e jetës " në Vrellë, prej 01.11.2018 i vazhdohet kontrata e punës edhe për 4 vite.
2. Obligohet Drejtoria për Arsim që drejtoreshës së lartcekur në pikën 1 t'i vazhdohet kontrata e punës në pajtim me procedurat e përcaktuara në udhëzimet administrative.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset, Drejtoria për Arsim.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: drejtoresha e lartcekur, drejtoria për arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-705/018	Data: Datum: 22.10.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), me kërkesë të Drejtorisë për Bujqësi, për formim të komisionit për pranimin e punëve në projektin " Hapja e rrugëve malore Gurrat e Bardha – Stanet e Strellcit ", numër të brendshëm 633/018/049/521-Lot 2, e realizuar nga operatori "Horn& Co. Kosova" SHPK, nga Lëbusha dhe nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për pranimin e punëve në projektin "Hapja e rrugëve malore Gurrat e Bardha – Stanet e Strellcit ", numër të brendshëm 633/018/049/521-Lot 2 dhe në të caktohen:

- 1) **Kushtrim Zogaj**, Zyrtar i Lartë për politika Bujqësore dhe Tregje, kryetar komisioni;
- 2) **Xhevat Idrizaj**, Zyrtar për Sivikulturë , anëtar;
- 3) **Ramë Blakaj**, teknik i pylltarisë, anëtar.

2. Komisioni i cekur më lartë, ka për obligim që të bëjë pranimin teknik të punëve në projektin "Hapja e rrugëve malore Gurrat e Bardha – Stanet e Strellcit " si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësitë tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Anëtarët e komisionit, Drejtorja për Bujqësi dhe Sektori i Prokurimit.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Anëtarët e Komisionit, Drejtorja për Bujqësi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-707/018	Data: Datum: 22.10.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), me kërkesë të Udhëheqëses së Prokurimit për formim të komisionit për vlerësimin e ofertave për vazhdimin e projektit " Hapja e rrugëve malore Cerrkolez-Lipë ", numër të brendshëm 633/018/076/536 e realizuar nga operatori "Te Aleni" SHPK, nga Vrella dhe nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për vlerësimin e ofertave për vazhdimin e projektit " Hapja e rrugëve malore Cerrkolez-Lipë ", numër të brendshëm 633/018/076/536 dhe në të caktohen:

- 1) **Beqir Metaj**, Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, kryesues;
- 2) **Daut Kabashi**, Udhëheqës i Sektorit të Pylltarisë, anëtar;
- 3) **Bajram Sejdiqaj**, teknik i pylltarisë, anëtar.

2. Komisioni i cekur më lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e ofertave për vazhdimin e projektit " Hapja e rrugëve malore Cerrkolez-Lipë " si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësitë tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Anëtarët e komisionit, Drejtoria për Bujqësi dhe Sektori i Prokurimit.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Anëtarët e Komisionit, Drejtoria për Bujqësi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komunë e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-708/018	Data: Datum: 22.10.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), me kërkesë të Udhëheqëses së Prokurimit për formim të komisionit për vlerësimin e ofertave në projektet: Loto 1 " Ndërtimi i ndriçimit publik dhe trotuareve në Banjë", Loto 2 " Ndërtimi dhe rregullimi i rrugëve dhe trotuareve në Istog ", Loto 3 " Ndërtimi i ndriçimit publik në Gurrakoc" dhe Loto 4 " Ndërtimi i hapësirave publike në zonat urbane " me numër të prokurimit 633-18-7251-5-2-1 dhe numër të brendshëm 633/018/071/521 dhe nxjerr:

V E N D I M

